



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 120 prot.

Kamëz, më 17.08.2022

V E N D I M

Nr. 102 Datë 17/08 2022

MBI

**“MIRATIMIN E KONTRATËS SË GRANTIT QË DO TË NËNSHKRUHET DHE ANGAZHIMIN E BURIMEVE FINANCIARE NË PARIM PËR BASHKËFINANCIMIN, TVSH-NË, MIRËMBAJTJEN NË KUADËR TË PROJEKTIT TË FINANCUAR NGA BE “MJEDIS I PASTËR, ARSIM I SHËNDETSHËM DHE CILËSOR NË SHKOLLA”**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.08.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.90 Datë 09.08.2022 bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; Shkresës nr. 155, datë 25.07.2022 “Njoftim mbi rezultatin e aplikimit të Bashkisë Kamëz”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontratës së grantit e cili do të nënshkruhet nga titullari i institucionit për projektin e financuar nga BE **“Mjedis i pastër, arsim i shëndetshëm dhe cilësor në shkolla”**;
2. Angazhimin e burimeve financiare për bashkëfinancimin e projektit në vlerën 715,580 (shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë në buxhetin vjetor dhe në programin buxhetor afatmesëm;
3. Angazhimin e burimeve financiare për pagesën e TVSH-së, në vlerën 1,103,011 (një milion e njëqind e tre mijë e njëmbëdhjetë) lekë në buxhetin vjetor dhe në programin buxhetor afatmesëm, në strukturën buxhetore: Gr.0. Prog. 6140 Art. 602, shumë që është planifikuar në buxhetin e vitit 2022. Buxheti total i projektit është 6,229,806 ( gjashtë milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë, ku BE financon 5,511,549 (pesë milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë;
4. Angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes në buxhetin vjetor dhe në programin buxhetor afatmesëm;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Integritimit në BE dhe Projekteve të Huaja dhe Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit e Treg.
  
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**NËN/ KRYETAR KËSHILLI**

**Ali DAUTI**

